



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

Nr. 272/prot.  
3

Tiranë, më 11.05.2023

VENDIM

Nr. 986, Datë 11.05.2023

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ  
NDËRMARRJES TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK NË TREGUN E  
SHËRBIMIT TAKSI PËR UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT  
NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.05.2023, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Hapja e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

**Baza Ligjore:** Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE :**

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka monitoruar tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
2. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit të tregut të shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u konstatua se, në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe zona Kiss&Fly) e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, nëpërmjet një table me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, nuk lejohet aksesi nga ndërmarrje të tjera të ofrojnë shërbimin e taksive për udhëtarë nga aeroporti drejt Tiranës të cilët nuk kanë pasagjerë brenda. Ky akses lejohet vetëm për taksitë e ndërmarrjes Auto Holiday Albania.

3. Tirana International Airport SHPK zotëron pozitë dominuese, pasi është i vetmi subjekt i cili ofron facilitetet esenciale në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës.
4. Për sa më sipër, vlerësojmë se, mund të jemi para shkeljes së nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku përcaktohet se përbën abuzim nga ana e një ndërmarrje me pozitë dominuese refuzimi për të ofruar shërbime/produkte duke i vendosur ato në kushte të pabarabarta konkurrence.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

### VENDOSI:


- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 11 maj 2023.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Leida MATJA**  
  
**Zv/Kryetar**

**Rezana KONOMI**  
  
**Anëtar**

**Adriana BERBERI**  
  
**Anëtar**

**Durim KRAJA**  
  
**Anëtar**

